

Universiteti i Evropës Juglindore



SEEU CAREER CENTRE
IT'S TIME TO BLOOM

Raporti i punësimit të diplomuarve të UEJL-së

Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive:.....	6
Qëllimi	6
Metodologjia.....	6
Gjetjet	7
Kufizimet	9
1. Gjetjet e anketimit	9
1.1 Kush ka marrë pjesë në anketim?.....	10
1.2 Shkalla e punësimit/papunësisë	11
1.2.1 Shkalla e përgjithshme e punësimit/papunësisë	11
1.2.2 Shkalla e punësimit brenda fakulteteve	14
1.2.3 Shkalla e punësimit sipas gjinisë	15
1.2.4 Shkalla e punësimit sipas gjuhës së studimit	16
1.2.5 Shkalla e punësimit sipas notës mesatare	17
1.2.6 Si mësuat për pozitën?.....	18
1.2.7 Sa kohë pas diplomimit keni gjetur një punë?.....	18
1.3 Punësimi sipas sektorit	19
1.3.1 Punësimi sipas lëmit të operimit.....	19
1.3.2 Fakultetet sipas industrisë së punësimit.....	20
1.3.3 Punësimi në sektorët e industrisë sipas gjinisë	24
1.3.4 Punësimi në sektorët e industrisë sipas gjuhës së studimit	24
1.3.5 Punësimi në sektorët e industrisë sipas notës mesatare.....	25

1.3.6 Punësimi sipas madhësisë së kompanisë.....	26
1.4 A jeni duke ndjekur një program studimi të ciklit të dytë?	28
1.5 Përgatitja për tregun e punës nëpërmjet programit studimor.....	31
Rekomandime	37

Tabela e grafikoneve

Grafikoni 1. Shpërndarja e të anketuarve sipas fakulteteve/departamenteve.....	10
Grafikoni 2. Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë.....	10
Grafikoni 3. Shpërndarja e të anketuarve sipas gjuhës së studimit.....	11
Grafikoni 4. Shkalla e Punësimit të Alumni në UEJL	12
Grafikoni 5. Lloji i punësimit	12
Grafikoni 6. Arsyeja e papunësisë.....	13
Grafikoni 7. Arsyeja e papunësisë * Ndjekja e studimeve të magjistraturës	13
Grafikoni 8. Statusi i punësimit nga Fakulteti	15
Grafikoni 9. Statusi i punësimit sipas gjinisë.....	15
Grafikoni 10. Arsyeja e papunësisë sipas gjinisë.....	16
Grafikoni 11. Statusi i punësimit sipas gjuhës së studimit.....	17
Grafikoni 12. Shkalla e punësimit sipas notës mesatare	17
Grafikoni 13. Si mësuat për këtë pozitë?	18
Grafikoni 14. Sa kohë pas diplomimit keni gjetur një vend pune?	18
Grafikoni 15. Shkalla e punësimit sipas sektorëve.....	19
Grafikoni 16. Punësimi lëmit të operimit.....	20
Grafikoni 17. Punësimi sipas lëmit të operimit për të diplomuarit e Fakultetit të BE.....	20
Grafikoni 18. Punësimi sipas lëmit të operimit për të diplomuarit e Fakultetit të SHTB	21
Grafikoni 19. Punësimi sipas lëmit të operimit për të diplomuarit e Fakultetit Juridik.....	21
Grafikoni 20. Punësimi sipas lëmit të operimit për të diplomuarit e Fakultetit GJKK	22
Grafikoni 21. Punësimi sipas lëmit të operimit për të diplomuarit e Fakultetit të SHSHB-së	23
Grafikoni 22. Punësimi në sektorët e industrisë sipas gjinisë.....	24
Grafikoni 23. Punësimi në sektorët e industrisë sipas gjuhës së studimit.....	25
Grafikoni 24. Punësimi në sektorët e industrisë sipas notës mesatare.....	26
Grafikoni 25. Punësimi sipas madhësisë së ndërmarrjes.....	26
Grafikoni 26. Punësimi sipas shtetit/rajonit	27
Grafikoni 27. Shpërndarja e punësimit brenda qyteteve të Maqedonisë së Veriut.....	27
Grafikoni 28. A po ndiqni një program të ciklit të dytë?.....	28
Grafikoni 29. Universiteti ku studioni	28
Grafikoni 30. Studentët sipas fakulteteve që ndjekin ciklin e dytë	29
Grafikoni 31. Studentët sipas fakulteteve dhe universiteteve që ndjekin ciklin e dytë	29
Grafikoni 32. Studentët e ciklit të II-të sipas notës mesatare.....	30
Grafikoni 33. Studentët e ciklit të dytë sipas statusit të punë.....	31

Grafikoni 34. Studentët e ciklit të dytë për arsye të papunësisë.....	31
Grafikoni 35. Vlerësimi i programit të studimit	32
Grafikoni 36. Vlerësimi i programit të studimit sipas fakultetit	32
Grafikoni 37. A keni pasur nevojë për kurse shtesë për punën që po punoni tani?	33
Grafikoni 38. Cila është arsyeja që nuk i keni vazhduar studimet e magjistraturës?	33
Grafikoni 39. Cila është arsyeja që keni vendosur t’i vazhdoni studimet e magjistraturës në UEJL?.....	34
Grafikoni 40. A do ta rekomandonit universitetin të tjerëve?.....	34
Grafikoni 41. Lëndët që ju rekomandoni në programin tuaj të studimit	35
Grafikoni 42. Llojet e shërbimeve	35
Grafikoni 43. Profili i kompanive të TI.....	36

Tabela e tabelave

Tabela 1. Punësimi sipas lëmit të operimit për të diplomuarit e Fakultetit Juridik (ndarje shtesë).....	22
---	----

Përmbledhja ekzekutive:

Qëllimi

Raporti i Punësimit është raport vjetor, i cili siguron të dhëna mbi statusin e punësimit të të diplomuarve në Universitetin e Evropës Juglindore. Raporti është përpiluar në atë mënyrë që të identifikohen punëdhënësit, të cilët në tregun e punës i punësojnë studentët e UEJL-së, çfarë përqindje marrin në punë, në cilat pozita si dhe të matim tregun për studentët e ardhshëm. Këto të dhëna, do të na ndihmojnë gjithashtu se si të përmirësojmë sferën tonë të mësimdhënies dhe nxënies në mënyrë që të plotësojmë nevojat e tregut për të diplomuarit e ardhshëm.

Metodologjia

Procesi i kontaktimit të studentëve të diplomuar është si në vijim-Shërbimi Studentor i UEJL-së i ofron Qendrës së Karrierës listën e përditësuar të studentëve të diplomuar dhe të gjitha informacionet e nevojshme. Raporti bazohet në hulumtime të gjera të krijuara nga kontaktimi i studentëve të diplomuar përmes thirrjeve telefonike direkte dhe plotësimit të formularit online (Google form) https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSdUj7iMrrG0Xv19KCBds5wmG-uHLDMDWH9R6ESSNRMXvo_geA/viewform?vc=0&c=0&w=1).

Por, për qëllimin e këtij raporti nevojitet informatë kthyesë nga studentët e diplomuar në lidhje me statusin e tyre të punësimit. Kjo u bë përmes një pyetësi.

Pyetësi përbëhej nga 30 pyetje të ndara në katër pjesë:

1. Pyetje faktike: ID, emri, mbiemri, gjinia, gjuha e studimit, fakulteti, nota mesatare,
2. Statusi i punësimit: a jeni i punësuar? emri i kompanisë, madhësia e kompanisë, sektori, periudha kohore;
3. Statusi i studimeve të magjistraturës: universiteti, fakulteti, qyteti, shteti;
4. Përgatitjet në UEJL për nevojat e tregut të punës: keni nevojë për kurse shtesë për vendin e punës, sa ju ka përgatitur fakulteti për tregun e punës, a rekomandoni lëndë më praktike?

Përgjigjet e marra u organizuan në Google format, të cilat u transferuan në format të grafikëve dhe tabelave në Excel dhe

janë në dispozicion në zyrën e Qendrës së Karrierës. Qëllimi është që ato të dhëna të jenë të disponueshme përmes sistemit të e-Arkivit të UEJL-së të krijuar kohët e fundit. Kontaktet u realizuan në periudhën nga 30.10.2019 deri më 06.12.2019.

Gjetjet

Pjesa e parë e anketimit përmban të dhëna faktike. Ndërsa nga rezultatet, numri më i madh i atyre që iu përgjigjën anketimit ishin të diplomuarit në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë me 23, 1%; të pasuar nga të diplomuarit në Fakultetin të Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, me 21.2%. Sa i përket gjinisë, përqindja e përgjithshme e meshkujve është 50.3% dhe femrave 49.6%. Sipas gjuhës së studimit, të diplomuarit që kanë studiuar në gjuhën shqipe janë 75.6%, ata që kanë studiuar në gjuhën angleze përbëjnë 12.9% dhe të diplomuarit me studim në gjuhën maqedonase u përfaqësuan me 11.4%.

Shkalla e përgjithshme e punësimit të të diplomuarve në UEJL në vitin 2018 është 59.87%. Nëse e heqim grupin e të diplomuarve, të cilët nuk janë të gatshëm të punojnë me zgjedhje (pushimi i lehonisë; studime master; hulumtim; çështje personale dhe të diplomuar të tjerë që nuk duan të punojnë), shkalla e punësimit të të diplomuarve të UEJL-së është 70% dhe shkalla e papunësisë është 30%. Nga këto 87.60%, janë të punësuar me orar të plotë, 10.30% janë vetë të punësuar (ata zotërojnë biznesin e tyre) dhe 1.03% janë të punësuar me kohë të pjesshme dhe bëjnë punën praktike. Nga numri i përgjithshëm i studentëve të papunë, 37.6% kanë deklaruar se janë të papunë sipas zgjedhjes së tyre.

Ndërsa në nivel të fakulteteve, shkalla më e lartë e papunësisë së të diplomuarve është në Fakultetin e Juridik me 44.8%, e ndjekur nga të diplomuarit në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore me 37.7%. Shkallë më të ulët e papunësisë këtë vit kanë të diplomuarit e Fakultetit të Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore, me 7.03%.

Të dhënat lidhur me gjininë, gjuhën e studimit dhe notën mesatare tregojnë se gjinia femrore tregon një shkallë më të lartë të papunësisë sesa të diplomuarit e gjinisë mashkullore me 34.1%. Kur u pyetën pse ishin të papunë, mes të diplomuarve femra dhe meshkuj, 41.5% e femrave dhe 31.4% e meshkujve u përgjigjën se kjo ishte sipas dëshirës së tyre. Të diplomuarit që studiuuan në gjuhën shqipe raportojnë një shkallë papunësie prej 31.4%, të diplomuarit që kanë studiuar në gjuhën angleze raportuan një shkallë papunësie prej 20.5%, dhe ata që kanë studiuar në gjuhën maqedonase raportuan një shkallë papunësie prej 25.8%. Të dhënat e këtij viti tregojnë se të diplomuarit me notë mesatare midis 7—8, kanë shkallë më të lartë të papunësisë, 38.2%. Të diplomuarit me notë mesatare midis 9 dhe 10, kanë shkallë të papunësisë me 25%, që tregon se ata janë më të punësuar se ata me notë mesatare më të ulët, gjithashtu ishin në kërkim për punë të mira të ofruara (janë më selektiv) dhe nuk ishin të gatshëm për të filluar në çfarëdoq punë që ju ofrohet atyre.

Sipas mënyrës se si ata mësuuan për pozitën e tyre aktuale të punës, 35.5% e tyre e kanë mësuar nga anëtarët e familjes;

24.07% nga interneti dhe 14.9% nga Qendra e Karrierës së UEJL-së.

Sa i përket periudhës kohore, 20.6% e të diplomuarve të UEJL-së, kanë treguar që ata ishin të punësuar para diplomimit; dhe 29.3% e të diplomuarve kanë gjetur punë në 3 muajt e parë pas diplomimit. Siç shihet këtu, 73% e të diplomuarve tanë janë të punësuar në vitin e fundit të studimeve ose gjashtë muajt e parë pas diplomimit.

Raporti përmban të dhëna për sektorin e punësimit në varësi të fakultetit. Të diplomuarit e Biznesit dhe Ekonomisë janë më së shumti të punësuar në Tregti (48.9%) dhe Shërbime (26.5%). Të diplomuarit në Shkencat dhe Teknologjitë Bashkëkohore kryesisht kanë gjetur punësim në sektorin e TI (60.5%) dhe Shërbime (15.7%). Të diplomuarit nga Fakulteti Juridik (48.1%) kanë gjetur punë në Shërbime dhe (22.2%) në Tregti. Nuk është për t'u habitur, punëdhënësi kryesor i të diplomuarve nga Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit këtë vit është sektori i Arsimit dhe Shërbimit (26.1%), i ndjekur nga industritë "tjera" (23.8%). Të diplomuarit nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore kanë gjetur punësim në "industri të tjera" (28.9%), ndërsa (26.3%), e tyre punojnë në Tregti, e ndjekur nga Shërbimet (15.7%).

Sipas qyteteve dhe qarqeve që të diplomuarit e UEJL themeluan marrëdhënie pune, ne mund të shohim që 26.8% e tyre punojnë në Tetovë, 27.8% në Shkup dhe 10.3% në Gostivar. Të diplomuarit e këtij viti gjithashtu kanë gjetur punësim në Evropë dhe vendet e tjera jo-evropiane me afërsisht 24.1% që është një përqindje e lartë.

Universiteti është i interesuar të dijë përqindjen e studentëve që ndjekin studimet e magjistraturës. Nga rezultatet, 65.10% e të diplomuarve nuk vazhdojnë studimet e ciklit të dytë dhe 34.80%, e tyre kanë vazhduar studimet e magjistraturës. Shumica e të diplomuarve që ndjekin studimet e ciklit të dytë po vazhdojnë në UEJL, ndërsa 8% e tyre kanë vazhduar në Evropë dhe 3.5% po ndjekin studimet magjistraturës në universitetet 'tjera'. Këto rezultate tregojnë interesimin e studentëve tanë për të vazhduar studimet në të njëjtin universitet, më shumë se sa në universitetet e tjera.

Kishte një seksion, ku studentët duhej të përgjigjen nëse programi i studimit i ka përgatitur ata për tregun e punës. Nga 34.50% e tyre janë përgjigjur se programi i studimit në fakultet e ka përgatitur për tregun e punës: 63.50% shumë, 10.10% neutral.

Kur u pyetën nëse të diplomuarit tanë-Alumni do t'ua rekomandojnë universitetin studentëve të tjerë, pothuajse të gjithë, 98.40%, kanë deklaruar PO, që tregon se ata janë të kënaqur me UEJL.

Cilët lëndë mendojnë të diplomuarit e UEJL-Alumni duhet të shtohen në programet tona ekzistuese të studimit? Sipas informatave kthyesë të tyre, 84.80% sugjerojnë lëndë praktike, 5.80% shkathtësi profesionale, 1.8% "shkathtësi të tjera", 5.5% shkathtësi të përgjithshme" dhe vetëm 1.80% prej tyre kanë treguar lëndë teorike. Duket se programet tona të studimit përfshijnë mjaft teori; ajo për të cilën duhet të përqendrohemi është pjesa praktike.

Kufizimet

Disa nga vështirësitë që lindën nga ky proces ishin që disa prej studentëve kishin ndryshuar numrin e tyre të kontaktit, ose ata ishin studentë ndërkombëtarë, siç është në rastin e studentëve nga Turqia, Shqipëria dhe Kosova. Mënyra alternative për të “kapur” këta studentë ishte përmes rrjeteve sociale, si: LinkedIn, Facebook dhe Instagram nga Zyra e PR-Uebmasteri. Kjo përbënte 14% të të dhënave të mbledhura.

Në pyetjen lidhur me industrinë, ku të diplomuarit tanë gjetën punë, kategoria ‘Tjetër’ përfaqëson përqindjen e dytë më të lartë, në përputhje me rrethanat, ky raport sugjeron që vitin e ardhshëm duhet të shtojmë më shumë kategori në fushën e operacioneve, për të identifikuar sektorët e punësimit më konkretisht.

1. Gjetjet e anketimit


Mostra e këtij viti u zgjodh bazuar në vitin e tyre kalendarik të diplomimit 2018.

Numri i përgjithshëm i kampionit të hulumtimit, ishin studentët e diplomuar të vitit 2018, ku kishte 457 të diplomuar. Synimi fillestar ishte përfshirja e të gjithë të diplomuarve, por disa prej tyre nuk donin t'i përgjigjeshin anketimit, kështu që madhësia e kampionit u zvogëluar në 364 të diplomuar. Nga numri i përgjithshëm i atyre që janë të gatshëm t'i përgjigjen anketës, kemi arritur në 324 prej tyre; shkalla e përgjigjes për studimin është 89% (324 nga 364). Të dhënat janë mbledhur përmes intervistave telefonike, LinkedIn, Facebook dhe Instagram. Të dhënat e mbledhura janë futur fillimisht në Excel spreadsheet dhe më pas janë përpunuar/analizuar duke përdorur analizë të thjeshtë sasiore dhe analiza multivariate (analiza të kryqëzuara).

Me një shkallë të përgjithshme përgjigjeje prej 89%, gjetjet e sondazhit besohet të jenë shumë të besueshme dhe të vlefshme. Për shkak të niveleve të larta të reagimit në mënyrë të vazhdueshme në nivel të ndryshueshëm, asnjë informacion mbi këto nuk është dhënë në këtë raport. Këto të dhëna dhe rezultate të analizave janë në dispozicion dhe mund të kërkohen në çdo kohë në Qendrën e Karrierës.


1.1 Kush ka marrë pjesë në anketim?

Kjo pjesë e parë ofron një përmbledhje të shpërndarjes së të anketuarve në hulumtim bazuar në variablat e klasifikimit: fakulteti, gjinia dhe gjuha e studimit.




Grafikoni 1. Shpërndarja e të anketuarve sipas fakulteteve/departamenteve

Grafikoni 1 paraqet informatën kthyesë të diplomuarve sipas fakultetit të tyre. Numri më i madh i të anketuarve është nga Biznesi dhe Ekonomia me 23, 1%; e ndjekur nga të diplomuarit e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, me 21, 2%. Numri më i ulët i të anketuarve është nga të diplomuarit e Fakultetit të Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore, me 15.7%.



Grafikoni 2. Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë

Grafikoni 2 tregon përqindjen e pjesëmarrësve bazuar në gjininë e tyre. Përqindja e përgjithshme është meshkujve 50.3% dhe femra 49.6%.



Grafikoni 3. Shpërndarja e të anketuarve sipas gjuhës së studimit


Sipas gjuhës së studimit, përqindja e përgjithshme e të diplomuarve që kanë studiuar në gjuhën shqipe është 75.6%. Ata që studiojnë në gjuhën angleze përbëjnë afërsisht 12.9% dhe të diplomuarit me gjuhë studimore maqedonisht u përfaqësuan nga 11.4% .

1.2 Shkalla e punësimit/papunësisë


Ky seksion paraqet gjetjet në lidhje me shkallën e punësimit të të diplomuarve në UEJL në vitin 2018. Shkalla e përgjithshme e punësimit është paraqitur në seksionin 1.2.1, pas kontrollit për marrëdhënie të mundshme statistike midis statusit të variabël të punësimit dhe variablave të ndryshëm të klasifikimit.

1.2.1 Shkalla e përgjithshme e punësimit/papunësisë

Shkalla e përgjithshme e punësimit të të diplomuarve në UEJL të vitit 2018, të treguar në (Grafikonin 4) është 59.87%. Nëse e heqim grupin e të diplomuarve, të cilët nuk janë të gatshëm të punojnë me zgjedhje (pushimi i lehonisë; studime të magistraturës; hulumtim; çështje personale dhe të diplomuar të tjerë që nuk duan të punojnë), sepse ky është grupi i studentëve që nuk kërkojnë punë dhe ata nuk mund të konsiderohen si një grup studentësh që kërkojnë/aplikojnë për një vend pune, shkalla e punësimit të të diplomuarve në UEJL është 70% dhe shkalla e papunësisë së tyre është 30%. Përshkrimet e hollësishme të shkallës së punësimit janë paraqitur në Grafikonin 6 dhe 7.




Grafikoni 4. Shkalla e Punësimit të Alumni në UEJL




Grafikoni 5. Lloji i punësimit

Sipas të diplomuarve të punësuar, 87.60% janë të punësuar me kohë të plotë, 10.30% janë të vetëpunësuar (ata kanë biznesin e tyre), dhe 1.03% janë të punësuar me kohë të pjesshme dhe bëjnë punën praktike.



Grafikoni 6. Arsyeya e papunësisë

Nga numri i përgjithshëm i studentëve të papunë (40.1%), treguar në Gafikonin 4, ekzistojnë dy kategori të ndara në Tabelën 6: ata që janë të papunë sipas zgjedhjes (nuk kërkojnë fare punë) dhe kategoria tjetër që kërkojnë një punë, por nuk janë në gjendje të gjejnë një të tillë. Siç shihet nga Grafikoni 6, 37.6% kanë treguar që janë të papunë sipas zgjedhjes, është vendimi i tyre (duke mos kërkuar/aplikuar fare për një vend pune). Në anën tjetër, 62.3% e atyre që nuk janë të punësuar nuk mund të gjejnë punë fare, ata kërkojnë dhe aplikojnë, por nuk janë të punësuar. Matjet shtesë në lidhje me shkallën e të diplomuarve që ndjekin studimet e magjistraturës, janë dhënë në seksionin 1.4.



Grafikoni 7. Arsyeya e papunësisë * Ndjekja e studimeve të magjistraturës

Grafikoni 7 dhe Grafikoni 4 japin përshkrim të hollësishëm mbi arsyen e papunësisë së studentëve të UEJL-së. Siç u përmend në Grafikonin 4, niveli i punësimit të studentëve të UEJL është afërsisht 60% dhe shkalla e papunësisë së tyre është 40%.

Ndërsa analizojnë shkallën e papunësisë (40%) të të diplomuarve në UEJL dhe arsyet e papunësisë së tyre, 15% e atyre të papunë janë duke ndjekur studimet e magjistraturës. Në këtë kategori, 8% studiojnë sipas dëshirës (kështu që ata duan vetëm të studiojnë dhe nuk kërkojnë fare punë) dhe 7% e tyre studiojnë për shkak të papunësisë (por në ndërkohë kërkojnë një vend pune).


Në anën tjetër, nga gjysma tjetër e të papunësuarve të diplomuar 25% të mbetur, janë një grup studentësh të cilët janë të papunë ose me zgjedhje (8%: duke mos aplikuar për një vend pune, çështje personale, pushim të lehonisë) ose të papunë sepse nuk mundën të gjejnë punë fare (duke aplikuar por pa mundur të punësohen).

Në këtë grafik, nuk janë shtuar grupi i studentëve që vazhdojnë studimet e magjistraturës, por në të njëjtën kohë janë të punësuar. Grafikoni 7 tregon vetëm një përshkrim të hollësishëm mbi arsyet e papunësisë.

Matjet shtesë në lidhje me shkallën e të diplomuarve që ndjekin studimet magjistraturës janë dhënë në seksionin 1.4.

1.2.2 Shkalla e punësimit brenda fakulteteve


Grafikoni 8 tregon rezultatet në statusin e punësimit lidhur me sfondin e diplomuarve sipas fakulteteve. Siç shihet, shkalla më e lartë e papunësisë së të diplomuarve është nga Fakulteti i Juridik me 44.8%, i ndjekur nga të diplomuarit e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore me 37.7%. Shkalla më e ulët e papunësisë këtë vit është gjetur për të diplomuarit e Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore, me 7.03%. Studentët e Shkencave Kompjuterike zakonisht janë të punësuar ndërsa studiojnë dhe kjo përvojë i ndihmon ata të ndërtojnë karrierë të hershme dhe të rrisin përqindjen e punësimit me 92.60%. Ndërsa, për sa i përket fakulteteve të tjera, studentët e Biznesit dhe Ekonomisë kanë një normë punësimi 76.50%, pasuar nga 70% e studentëve nga Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, 62.20% e të diplomuarve nga Shkencat Shoqërore Bashkëkohore dhe 55.10% e atyre që kanë diplomuar në Fakultetin Juridik.




Grafikoni 8. Statusi i punësimit nga Fakulteti

1.2.3 Shkalla e punësimit sipas gjinisë

Në grafikoni 9 dhe 10, është treguar statusi i punësimit sipas gjinisë. Siç shihet, të diplomuarit femra regjistrojnë një shkallë më të lartë papunësie me 34.1%, sesa të diplomuarit meshkuj me 25.3%. Nëse analizojmë shkallën e punësimit të të diplomuarve, mund të shohim që, meshkujt janë më të punësuar me 74.6% sesa femrat me 65.8%.



Grafikoni 9. Statusi i punësimit sipas gjinisë




Grafikoni 10. Arsyeja e papunësisë sipas gjinisë

Kur u pyetën pse ishin të papunë, mes të diplomuarve femra dhe meshkuj, 41.5% e femrave dhe 31.4%, e meshkujve u përgjigjën se ishte sipas dëshirës. Grafikoni 10, tregon se sa të diplomuar nuk mund të gjejnë punë, nga rezultatet del se 68.5%, e meshkujve dhe më pak femrat me 58.4% nuk kanë mundur të gjejnë punë fare.

1.2.4 Shkalla e punësimit sipas gjuhës së studimit


Siç shihet nga grafiku më poshtë, ekzistojnë dallime midis të diplomuarve, gjuha e studimit e të cilëve ishte shqip dhe ata që gjuha e studimit ishte anglisht dhe maqedonisht, sipas papunësisë së tyre. Të diplomuarit që studiojnë në gjuhën shqipe raportojnë një shkallë papunësie prej 31.4%, të diplomuarit që studiojnë në gjuhën maqedonase raportuan 25.8% të shkallës së papunësisë dhe ata që studiojnë në gjuhën angleze raportojnë një normë papunësie prej 20.5%. Ndërsa nga rezultatet, niveli më i lartë i punësimit të të diplomuarve ishte në ata që studiojnë në gjuhën angleze me 79.4%, i ndjekur nga ata që studiojnë në gjuhën maqedonase me 74.1% dhe më pak të punësuar të diplomuar të regjistruar në gjuhën shqipe me 68.5%. Ky grafik tregon domosdoshmërinë e nevojës së tregut të punës për të diplomuarit, gjuha e studimit e të cilëve ishte anglishtja, sepse përveç fushës së studimit ata fitojnë edhe të diplomuar të cilët janë gjithashtu të kanë shkathtësi të shumë të mira në gjuhën angleze.



Grafikoni 11. Statusi i punësimit sipas gjuhës së studimit

1.2.5 Shkalla e punësimit sipas notës mesatare


Grafikoni 12 tregon statusin e punësimit sipas notës mesatare të studentëve. Të dhënat e këtij viti tregojnë se të diplomuarit me notë mesatare ndërmjet 7—8, kanë shkallë më të lartë të papunësisë 38.2%. Të diplomuarit me notë mesatare ndërmjet 9 dhe 10, kanë shkallë të papunësisë me 25%, që tregon se ato kanë shkallë më të lartë të punësimit sesa ato me notë mesatare më të ulët. Studentët me notë mesatare më të lartë gjithashtu kërkonin vendet e punës më të mira (janë më selektiv) dhe nuk ishin të gatshëm të punësoheshin në çfarëdo pune që ju ofrohet atyre. Sa i përket shkallës së punësimit, të diplomuarit me notë mesatare në mes 9—10, kanë shkallë më të lartë të punësimit me 75%, të ndjekur nga ata me notë mesatare në mes 6—7, kanë normë punësimi me 73%. Më pak të punësuar janë të diplomuarit me notë mesatare në mes 7—8, kanë shkallë punësimi me 61.70%. Detajet në lidhje me sektorin e punësimit janë dhënë në seksion 1.3.



Grafikoni 12. Shkalla e punësimit sipas notës mesatare

1.2.6 Si mësuat për pozitën?


Sipas të diplomuarve të punësuar, 35.5% prej e tyre kanë mësuar për vendin e tyre aktual të punës nga anëtarët e familjes; 24, 07% nga Interneti dhe 14.9% nga Qendra e Karrierës së UEJL-së. Rezultatet më të ulëta janë raportuar për gazetatat, të cilat shënojnë vetëm 4.60%.



Grafikoni 13. Si mësuat për këtë pozitë?

1.2.7 Sa kohë pas diplomimit keni gjetur një punë?

Siç tregohet në prezantimin grafik më poshtë, 20.6% e të diplomuarve kanë treguar se kanë qenë të punësuar që para diplomimit; dhe 29.3% e të diplomuarve kanë gjetur një vend pune 1-3 muaj pas diplomimit. Siç shihet këtu, 73% e të diplomuarve tanë janë të punësuar në vitin e fundit të studimeve, ose gjashtë muajt e parë pas diplomimit.



Grafikoni 14. Sa kohë pas diplomimit keni gjetur një vend pune?


1.3 Punësimi sipas sektorit

Seksioni vijues jep të dhëna në lidhje me sektorin e punësimit. Vlen të përmendet se termi "sektor" në këtë raport është i ndarë në tre kategori: publike, private dhe të tjera. Megjithatë, kjo nuk jep shumë detaje në lidhje me punësimin e të diplomuarve. Si një variabël e dytë është përfshirë "Industria", e cila ofron një përshkrim më të detajuar të punësimit të të diplomuarëve në drejtim të përcaktimit të tyre.


Këto dy variabla janë ekzaminuar për lidhshmërinë e mundshme me disa nga variablat e klasifikimit, por janë përfshirë vetëm në ato raste që janë dëshmuar të jenë statistikiisht të rëndësishme.

1.3.1 Punësimi sipas lëmit të operimit

Grafikoni në vazhdim tregon se përqindja e punësimit në sektorin privat dhe atë publik është afërsisht e njëjtë. Kështu, 42% e të diplomuarve të UEJL-së kanë gjetur punësim në sektorin privat dhe 41% të numrit të përgjithshëm të të diplomuarve të punësuar punojnë në sektorin publik. Marrëdhënia midis sektorit të punësimit dhe gjuhës së studimit është paraqitur në seksion 1.3.4.



Grafikoni 15. Shkalla e punësimit sipas sektorëve




Grafikoni 16. Punësimi lëmit të operimit

Kjo prirje është paraqitur edhe në grafikun 16; duke treguar të dhëna në nivel të industrisë, ku “Shërbimet” paraqiten me 25.2%, dhe “Tregtia” me 23.1%, që të dy janë punëdhënësit më të mëdhenj të të diplomuarve në UEJL. Sektori “Tjetër” është akoma i përfaqësuar me 17.5%, që tregon hapësirë për më shumë ndarje në lidhje me sektorin e punësimit në të ardhmen.

1.3.2 Fakultetet sipas industrisë së punësimit

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë


Siç shihet nga Grafikoni 17, të diplomuarit e Biznesit dhe Ekonomisë janë të punësuar në të gjitha kategoritë e industrisë të përfshira në këtë hulumtim. “Tregtia” 48.9% dhe “Shërbimet” 26.5% janë kategori që punësojnë më shumë të diplomuar në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë.



Grafikoni 17. Punësimi sipas lëmit të operimit për të diplomuarit e Fakultetit të BE

Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore


Të diplomuarit në Shkencat dhe Teknologjitë Bashkëkohore kryesisht gjetën punësim në sektorin e “TI” me 60.5% dhe “Shërbime” me 15.7%. Sektorët më pak të përfaqësuar janë: “Arsimi”, “Tregtia”, “Media” dhe “të tjera”.



Grafikoni 18. Punësimi sipas lëmit të operimit për të diplomuarit e Fakultetit të SHTB

Fakulteti Juridik

Të diplomuarit e Fakultetit Juridik 48.1% kanë gjetur punë në “Shërbime” dhe 22.2% në “Tregti”. Pjesa tjetër kryesisht kanë gjetur punë në “Qeveri” me 18.5%, dhe “Industritë tjera” me 11.1%.



Grafikoni 19. Punësimi sipas lëmit të operimit për të diplomuarit e Fakultetit Juridik


Fusha e operimit	Përqindja
Institucionet Publike	22.2%
Tjera	51.8%
Noteri	25.9%

Tabela 1. Punësimi sipas lëmit të operimit për të diplomuarit e Fakultetit Juridik (ndarje shtesë)

Tabela 1, tregon përqindjen e të diplomuarve të Fakultetit Juridik të punësuar sipas sektorit. Sipas tabelës, përqindja më e lartë kanë gjetur punësim në “Institucionet e tjera”, me 51.8%, gjë që tregon se duhet të shtojmë më shumë ndarje në Raportin e ardhshëm të punësimit, i ndjekur nga “Noteria” me 25.9% dhe “Institucionet Publike” me 22.2%.

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimi


Nuk është për t'u habitur, punëdhënësi kryesor i të diplomuarve në Gjuhë, Kulturë dhe Komunikim këtë vit është sektori i “Arsimit” dhe “Shërbimet”, secili me 26.1%, i ndjekur nga “Industri të tjera” me 23.8%, “Media” përfaqësohet me 14.2% dhe “Tregtia” me 7.1%.



Grafikoni 20. Punësimi sipas lëmit të operimit për të diplomuarit e Fakultetit GJKK

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore


Siç shihet nga prezantimi grafik, 28.9% e të diplomuarve në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore kanë gjetur punësim në “Industri të tjera”, ndërsa 26.3% e tyre punojnë në “Tregti”, e ndjekur nga “Shërbimet” me 15.7%.



Grafikoni 21. Punësimi sipas lëmit të operimit për të diplomuarit e Fakultetit të SHSHB-së

1.3.3 Punësimi në sektorët e industrisë sipas gjinisë

Siç shihet nga paraqitja grafike më poshtë, nuk ka ndonjë ndryshim të madh në shkallët e punësimit të meshkujve dhe femrave brenda sektorëve specifikë të punësimit, megjithëse ka sektorë në të cilët një gjini më së shumti ka gjetur punësim.



Grafikoni 22. Punësimi në sektorët e industrisë sipas gjinisë


Duke parë punëdhënësin më të madh të të diplomuarve të UEJL-së, meshkujt kanë shkallë më të lartë punësimi në “Tregti” me 25.6%, dhe “Shërbimet”, me 22.0%. Meshkujt janë më pak të punësuar në “Media” dhe “Arsim”, me 4,5%. Nga ana tjetër, femrat janë më të punësuar në “Shërbime”, me 29.4%. Femrat janë më pak të punësuar në “Qeveri”, me 2.3%, dhe “Media”, me 5.8%.

1.3.4 Punësimi në sektorët e industrisë sipas gjuhës së studimit

Nuk ka ndonjë ndryshim të madh në shpërndarjen e të diplomuarve brenda industrive specifike të punësimit kur merret parasysh gjuha e tyre e studimit. Sidoqoftë, disa nga sektorët janë më shumë të përfaqësuar në lidhje me gjuhën e studimit.

Alumni i UEJL-së që kanë studiuar në gjuhën shqipe janë të më përfaqësuar në industri si “Tregtia” me 27.0%, “Shërbime” me 25.6% dhe të “Tjetër” me 15.2%, ndërsa ata janë më pak të punësuar në “Media” me 5.5% dhe “Arsim” me 6.2%. Të diplomuarit që e kanë patur gjuhën maqedonase gjuhë studimi janë më të përfaqësuar në “Shërbime” dhe “Tjetër” me

26.0%, të ndjekur nga “Arsimi” me 17.3%, dhe shumë pak në “Qeveri” dhe “Media” me afërsisht 4.3%. Të diplomuarit që kanë gjuhën angleze si gjuhë studimi gjetën punësisht kryesisht në arsim, “Shërbime” dhe “të tjera” me 22.2%, dhe aspak në “Qeveri”.




Grafikoni 23. Punësimi në sektorët e industrisë sipas gjuhës së studimit

1.3.5 Punësimi në sektorët e industrisë sipas notës mesatare


Grafiku i ardhshëm paraqet lidhshmërinë ndërmjet variablave nota mesatare dhe industrisë së punësimit. Siç mund të shihet grafikoni, një lidhshmërinë në mes të këtyre dy variablave duket se ekziston.

Edhe pse përfaqësohen në të gjithë sektorët, të diplomuarit me notë mesatare të lartë dhe të ulët kryesisht kanë gjetur punë në të njëjtat industri. Të diplomuarit me notë mesatare më të lartë më së shumti kanë gjetur punësim në “Shërbime” 28%, pasuar nga “TI” me 22.2%, më pak të punësuar në “Media” dhe “Qeveri” me 3%. Të diplomuarit me notë mesatare 8—9, më së shumti kanë gjetur punë në “Tregti” me 26%, më pak të punësuar në “Qeveri” me 2%. Nga ana tjetër, të diplomuarit me notë mesatare 7—8, më së shumti kanë gjetur punësim në “Shërbime” me 26.10%, më pak të punësuar në “Qeveri” me 4.70%. Të diplomuarit me notë mesatare të ulët kanë gjetur punë më së shumti në “Shërbime” me 28.7%, më pak të punësuar në “Media” me 2.7%.




Grafikoni 24. Punësimi në sektorët e industrisë sipas notës mesatare

1.3.6 Punësimi sipas madhësisë së kompanisë




Grafikoni 25. Punësimi sipas madhësisë së ndërmarrjes

Sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe vendit-qtetit, shumica e të diplomuarve kanë gjetur punësim në firma të vogla (10-49 të punësuar) 39.1%, mikro firma ka (0-9 të punësuar) me 35.5%. Sipas madhësisë së kompanisë, të diplomuarit në vitin 2018, janë më pak të punësuar në firma të mëdha (mbi 250 të punësuar), me 10.8%



Grafikoni 26. Punësimi sipas shtetit/rajonit

Siç shihet në grafikunin e mësipërme, 74.7% e të diplomuarve kanë gjetur punësim në Maqedoninë e Veriut, 12.3% në vendet evropiane, 5.06% në Kosovë, 4.60 vende të tjera. Shqipëria dhe SH.B.A përfaqësohet me 1%.




Grafikoni 27. Shpërndarja e punësimit brenda qyteteve të Maqedonisë së Veriut

Grafikoni 27 tregon shpërndarjen e punësimit në qytetet e Maqedonisë së Veriut. Siç shihet, 26.8% e të diplomuarve kanë gjetur punë në Tetovë, 27.8% në Shkup dhe 10.3% në Gostivar. Të diplomuarit e këtij viti kanë gjetur punë edhe në Evropë dhe vendet e tjera jo-evropiane me 24.1% që është një përqindje e lartë.


1.4 A jeni duke ndjekur një program studimi të ciklit të dytë?

Grafikoni 28, tregon numrin e përgjithshëm të të diplomuarve të UEJL-së që ndjekin studimet e tyre të magjistraturës. Nga ku 65.10% e të diplomuarve nuk ndjekin studimet e ciklit të dytë dhe 34.80% e tyre kanë vazhduar studimet e magjistraturës. Ekziston një pyetje shtesë që i mat arsyet e mos ndjekjes së studimeve të magjistraturës.




Grafikoni 28. A po ndiqni një program të ciklit të dytë?

Universiteti është i interesuar të dijë se ku i vazhdon studimet Alumni ynë. Shumica e të diplomuarve (84.9%), që ndjekin studimet e ciklit të dytë, vazhdojnë arsimin e tyre në UEJL, ndërsa 8% e tyre e bëjnë këtë në Evropë dhe 3.5% i ndjekin studimet e magjistraturës në “universitete të tjera”. Këto rezultate tregojnë interesimin e studentëve tanë për të vazhduar studimet në të njëjtin universitet, më shumë se sa në universitetet e tjera.




Grafikoni 29. Universiteti ku studioni

Duke parë shkallën e të diplomuarve që ndjekin studimet e magjistraturës brenda secilit fakultet, Grafikoni 30, tregon qartë se të diplomuarit e Juridikut (27.4%) dhe të diplomuarit e Biznesit dhe Ekonomisë (24.7%), kryesisht e vazhdojnë arsimin e tyre pas mbarimit të studimeve deridiplomike. Këtë vit, të diplomuarit e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimeve përfaqësohen me 18.50%, të diplomuarit e Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore me 15.90%, të ndjekur nga të diplomuarit e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore me 13.20%, të cilët duket se kanë më pak interes për të ndjekur studimet e tyre të magjistraturës.




Grafikoni 30. Studentët sipas fakulteteve që ndjekin ciklin e dytë



Grafikoni 31. Studentët sipas fakulteteve dhe universiteteve që ndjekin ciklin e dytë


Grafikoni 31, tregon lidhshmërinë midis regjistrimit të studimeve të ciklit të dytë sipas fakultetit dhe universitetit. Numri më i lartë i studentëve të Biznesit dhe Ekonomisë vazhdojnë ciklin e dytë të studimeve në UEJL, 89.2%. Përqindja e studentëve që regjistrohen në studimet e magjistraturës në UEJL nga Shkencat dhe Teknologjitë Bashkëkohore është 55.5%, e ndjekur nga universitetet e Evropës, me 38.8%, që tregon një përqindje shumë të ngushtë të këtyre studentëve të gatshëm të vazhdojnë studimet jashtë vendit, në krahasim me UEJL-në. Me një përqindje prej 93.5%, studentët e Juridikut vazhdojnë studimet e tyre të magjistraturës në UEJL dhe studentët e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimeve regjistrojnë ciklin e tyre të dytë në UEJL, me 90.4%. Studentët e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore regjistrohen për të ndjekur studimet e magjistraturës në UEJL me 86.60%.




Grafikoni 32. Studentët e ciklit të II-të sipas notës mesatare

Grafikoni 32, tregon lidhshmërinë ndërmjet studentëve të magjistraturës dhe notës mesatare të tyre. Përqindja më e lartë e atyre që vazhdojnë studimet e tyre të magjistraturës kanë diplomuar me notë mesatare 9 -10, dhe 8—9 notë mesatare, respektivisht 29.20% dhe 27.40%. Përqindja më e ulët e atyre që vazhdojnë studimet e tyre të magjistraturës janë ato me notë mesatare ndërmjet 6-7 me 20.30%.

Grafikoni 33 dhe 34, shqyrtojnë lidhshmërinë midis variablave që ndjekin studimet e ciklit të dytë, statusin e punësimit dhe arsyen e papunësisë. Siç mund të shihet nga Grafikoni 34, të diplomuarit që nuk mund të gjejnë punë janë duke ndjekur studime të magjistraturës. 46% e studentëve të MA janë të papunë, ndërsa 45.1% janë të punësuar me kohë të plotë. 54% e studentëve të MA janë të papunë sipas zgjedhjes dhe 54% e tyre nuk mund të gjejnë punë.



Grafikoni 33. Studentët e ciklit të dytë sipas statusit të punë




Grafikoni 34. Studentët e ciklit të dytë për arsye të papunësisë


1.5 Përgatitja për tregun e punës nëpërmjet programit studimor

Në këtë pjesë, studentët janë përgjigjur nëse programi i studimit i ka përgatitur ata për tregun e punës. Variabla është matur sipas shkallës Likert me pesë pikë (1=shumë pak & 5 shumë më shumë).

Sidoqoftë, pasi kjo pyetje ka të bëjë me programin e studimit dhe jo me Universitetin në përgjithësi, jepet një pamje edhe më e mirë kur merret parasysh fakulteti në të cilin akne studiuar. Rezultatet e kësaj analize të tabelave të kryqëzuara janë dhënë në Grafikonin 36, ku shihet se 34.50% e studentëve janë përgjigjur se programi i studimit në fakultet i ka përgatitur ata për tregun e punës: 63.50% shumë më shumë, 10.10% neutral. Këtë vit nuk kishte asnjë prej tyre që u përgjigj “shumë pak”.




Grafikoni 35. Vlerësimi i programit të studimit




Grafikoni 36. Vlerësimi i programit të studimit sipas fakultetit

Grafikoni 36, i paraqet vlerat mesatare të shënuara për secilin fakultet, në mënyrë që të mund të bëhet një krahasim. Siç mund të shihet më së miri nga Grafikoni i vlerave mesatare, të diplomuarit e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimi raportojnë në shkallë 69.50% janë shumë më shumë të kënaqur dhe 68.60% e të diplomuarve të Shkencave Bashkëkohore dhe Teknologjive janë kryesisht të kënaqur nga programi i tyre i studimit.




Grafikoni 37. A keni pasur nevojë për kurse shtesë për punën që po punoni tani?

Matja e cilësisë së programit të studimit dhe mënyra se si Alumni u përball me punësimin e tyre, ne u kemi parashutuar pyetjen; A do të kishin nevojë për një kurse shtesë për tu përgatitur më mirë për punën aktuale?. Nga rezultatet, shihet se 13.4% e të diplomuarve kanë nevojë për kurs dhe 86.5% nuk kanë nevojë për ndonjë kurs shtesë për punën që ata bëjnë.




Grafikoni 38. Cila është arsyeja që nuk i keni vazhduar studimet e magjistraturës?

Duke analizuar shkallën e punësimit të të diplomuarve dhe mënyrën se si ata përballen me tregjet e punës, ndryshimet dhe nevojat e biznesit, Universiteti gjithashtu është i interesuar të dijë pse të diplomuarit tanë nuk kanë vazhduar studimet e tyre për magjistraturë. Sipas përgjigjeve të tyre siç shihet në Grafikonin 38, 16.5% e tyre kanë deklaruar se i kanë ndërprerë studimet për shkak të “çështjeve financiare” dhe 12.7% për arsye “tjera”. Janë 3.30%, që nuk i kanë vazhduar studimet e tyre për shkak të “zhvillimit të karrierës”. Më pak se 1% e tyre nuk janë të kënaqur nga stafi administrativ, akademik dhe programi i studimit, që është një përqindje e ulët. Këto përqindje tregojnë se të diplomuarit tanë janë të kënaqur me “Diplomën” dhe kushtet dhe stafin që hasin në UEJL. Shumica e tyre që nuk vazhdojnë studimet e magjistraturës janë grupi i të diplomuarve që kërkojnë të gjejnë punë dhe më pas të vazhdojnë studimet e tyre të magjistraturës.




Grafikoni 39. Cila është arsyeja që keni vendosur t'i vazhdoni studimet e magjistraturës në UEJL?

Në pyetjen - Cila është arsyeja që keni vendosur të vazhdoni studimet e magjistraturës?; 50.40% nuk i kanë vazhduar studimet për shkak të “zhvillimit të karrierës”, dhe 11.50% për shkak të “programit të studimit”. Vetëm 10.60% e tyre kanë treguar se nuk i kanë vazhduar për shkak të “çështjeve personale”.




Grafikoni 40. A do ta rekomandonit universitetin të tjerëve?

Kur u pyetën nëse të diplomuarit tanë-Alumni do t’ua rekomandonin universitetin studentëve të tjerë, pothuajse të gjithë, 98.40%, kanë deklaruar “PO”, që tregon se ata janë të kënaqur me UEJL.



Grafikoni 41. Lëndët që ju rekomandoni në programin tuaj të studimit


Cilat lëndë mendojnë të diplomuarit e UEJL-Alumni se duhet të shtohen në programet tona ekzistuese të studimit? Sipas informatës kthyesë të tyre, 84.80% sugjerojnë “lëndë praktike”, 5.80% “shkathtësi profesionale”, 1.8% “shkathtësi të tjera”, 5.5% “shkathtësi të përgjithshme” dhe vetëm 1.80% e tyre kanë treguar “lëndë teorike”. Duket se programet tona të studimit përfshijnë mjaft teori; por ajo për të cilën duhet të përqendrohemi është pjesa praktike.



Grafikoni 42. Llojet e shërbimeve

Nevoja për të njohur llojin e shërbimeve në të cilat të diplomuarit tanë gjejnë punë janë arsyeja pse ne kemi shtuar një ndarje shtesë mbi to. Sipas tabelave më poshtë, mund të shohim që 40.80% punojnë në shërbimet 'Tjera'. 16.3% punojnë në "Banka", 14.20% në "Shërbime Juridike" dhe "Këshillim". Përqindja më e ulët, vetëm 4% e të diplomuarve, punojnë në kompanitë e "Kontabilitetit dhe Sigurimet".

Sa i përket studentëve të Shkencave Kompjuterike, ne mund të shohim se shumica e tyre, 39.40%, punojnë në kompani "programimi dhe zhvillimi softuerësh", ndërsa 21% e të diplomuarve kanë gjetur një vend pune në "shkencat kompjuterike dhe hulumtim" dhe 15.7% në fushat e "tjera" dhe 7.80% në "trajnim dhe mbështetje". Përqindja më e ulët e të diplomuarve në shkencat kompjuterike ka gjetur një vend pune në "ueb dhe internet shërbime dhe telekomunikacion", me vetëm 2.6% .



Grafikoni 43. Profili i kompanive të TI

Rekomandime

- Alumni ynë janë përgjigjur se ata kanë ndjekur trajnim pasi kanë gjetur një vend pune; duhet të pyesim se cilin trajnim e kanë ndjekur. Këto të dhëna, do ta ndihmojnë Universitetin, që t'i ofrojë këto kurse si lëndë zgjedhore të lira në vitet e ardhshme dhe në formën e trajnimeve përmes Qendrës së Zhvillimit të Biznesit.
- Sa u përket përvojave dhe zhvillimit të mëtejshëm: analizat e raportit aktual çojnë në përfundimin se në këtë fazë janë 30% e studentëve që nuk janë në gjendje të gjejnë një vend pune. Universiteti duhet të mendojë që të ofrojë lëndë gjatë procesit të tyre të studimit mbi zhvillimin e karrierës: shkrim të CV-së, letër motivimi, teknika të intervistës, mjete të kërkimit të punës, gjuhë dhe të ngjashme.
- Universiteti, duhet t'i inkurajojë të diplomuarit ta përdorin Qendrën e Biznesit dhe Inovacionit (Parku Teknologjik), për realizimin e ideve në formën e *“start up”*, në mënyrë që të dalin me plan të suksesshëm të biznesit, menjëherë pasi t'i mbarojnë studimet.
- Përqindje shumë e madhe, ose 84.80% e Alumnit tonë deklaruan se duhet të shtojmë lëndë më praktike. Universiteti duhet të mendojë se cilat lëndë janë të nevojshme për nevojat e tregut të punës.
- Përqindje e konsiderueshme, ose 65% e Alumnit tonë deklaruan se nuk i ndjekin studimet e magjistraturës. Duhet të bëhen më shumë analiza për arsyet se pse studentët nuk vazhdojnë me studimet e magjistraturës në UEJL.